

250 PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR I PËRGJITHSHËM

Fusha përmban pikëqasjen lëndore në formën e emrit të përgjithshëm.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
250	Pikëqasja e njësuar – emër i përgjithshëm	nr
a	<i>Elementi fillestar</i>	nr
n	<i>Kodi për kategorinë lëndore</i>	nr
m	<i>Kodi për nënkategorinë lëndore</i>	nr
x	<i>Përcaktuesi i përgjithshëm</i>	r
y	<i>Përcaktuesi gjeografik</i>	r
z	<i>Përcaktuesi kohor</i>	r
9	<i>Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes</i>	nr

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfushat x, y dhe z janë përshkruar në kapitullin *Përcaktuesit*, ndërsa nënfusha 9 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

250a Elementi fillestar

Termi në formën që e përcakton sistemi i përdorur i pikëqajeve lëndore.

250n Kodi për kategorinë lëndore

Kodi tregon kategorinë lëndore.

a	<i>protagonistë</i> Termet që prezantojnë shkaktarët, pjesëmarrësit, përfaqësuesit ose ekzekutuesit e një veprimi (individual ose kolektiv): grupet demografike, organizatat dhe organizmat.
b	<i>veprime</i> Termet për llojet e ndryshme të veprimeve: aktivitetet, disiplinat dhe proceset.
c	<i>gjësende</i> Termet që kanë të bëjnë me entitetet e prekshme ose abstrakte: format, objektet, lëndët, hapësirat, gjërat materiale dhe jomateriale.

d	<i>kohë</i> Termtat e lidhur me kohën: periudha dhe termtat e tjerë kohorë.
----------	--

250m Kodi për nënkategorinë lëndore

Kodi tregon nënkategorinë lëndore.

a1	<i>grupe demografike</i> Grupet e personave, që nuk i takojnë asnjë organizate, dhe personat e veçantë si pjesë e grupit, i cili është përcaktuar bazuar në karakteristikat specifike, siç është sjellja, veprimtaria ose statusi (gjendja juridike, e punësimit, shoqërore, fizike ose mentale, statusi civil, lidhja familjare, gjinia, moshja, përkatësia gjeografike dhe kombëtare). Shembuj: Gjeologët, Të papunët, Beqarët, Sllovenet.
a2	<i>organizata</i> Komunitetet e njerëzve me aspirata të përbashkëta, pavarësisht faktit se si dhe me çfarë qëllimi janë organizuar. Organizatat me sektorë të ndryshëm të veprimtarisë, institucionet publike dhe pjesët e organizatave. Shembuj: Institucionet shëndetësore, Shoqërit kulturore, Muzetë, Gjykatat etj. Përfjashtimet: Grupet e njerëzve që nuk janë të organizuar klasifikohen në "a1"; organizatat tek të cilat më e rëndësishme është struktura fizike (p.sh. fabrikat), se sa aspekti organizativ (siç e kanë bibliotekat), klasifikohen në "c2"; veprimtaritë ekonomike (p.sh. industria ushqimore), e jo organizatat që janë akterë kolektivë në këtë veprimtari (p.sh. siç janë bizneset ushqimore), klasifikohen në "b1".
a3	<i>organizma</i> Organizmat e gjallë (mikroorganizmat, bimët, kafshët, njerëzit), pjesët e tyre anatomike dhe grupet e organizmave. Shembuj: Fosilet, Qershia (bimë), Neandertalët, Mëlqia, Qentë e gjahut, Kolonitë (kafshë). Përfjashtime: Grupet e personave klasifikohen në "a1"; bashkësitë bimore në hapësirë (pyjet etj.) klasifikohen në "c4"; përbërësit themelor kimik klasifikohen në "c5".
b1	<i>veprime</i> Veprimet që i kryen akteri direkt i përcaktuar qartë. Këta janë termtat nga disiplina ose fusha të ndryshme: arti dhe letërsia, shkencat dhe teknika, ekonomia, drejtësia, historia, ushtria, politika, teologjia, shkencat e informacionit, sporti dhe rekreacioni, aktivitetet mendore, aktivitetet interpretuese etj. Këtu bëjnë pjesë edhe termtat e përgjithshëm siç janë: veprimi, përdorimi etj. Shembuj: Muzika, Inovacionet teknologjike, Katalogimi, Lojrat olimpikë, Tenisi, Beteja në Akcium (Romë, 31 p.e.r.). Përfjashtime: Veprimet që nuk kanë akter direkt dhe krijohen nga një shkaktar (natyror, shoqëror etj.) klasifikohen në "b3"; kur mbulohen me terma të tjerë, përparësi u jepet këtyre të fundit.
b2	<i>diciplina</i> Veprimet që janë të lidhura me veprimtari kërkimore, me grumbullimin dhe shpërndarjen e dijes dhe kanë strukturë organizative formale (qendrat kërkimore, institutet universitare, botimet shkencore etj.). Këtu bëjnë pjesë: shkencat, shkencat humane dhe natyrore, mjekësia, teknika dhe disiplinat për zbatim të përgjithshëm (p.sh. statistika, shkencat e informacionit). Shembuj: Paleontologjia, Leksikologjia, Etika, Bibliografia, Shkencat e mjedisit, E drejta penale. Përfjashtime: Pseudodisiplinat (p.sh. astrologjia) dhe disiplinat në të cilat komponentet praktike qartë dominojnë mbi ato kërkimore (p.sh. kirurgjia), klasifikohen në "b1".
b3	<i>proceset</i> Veprimet, të cilat nuk i shkakton një akter i vetëm (personi ose organizata), mirëpo kanë disa shkaktarë (natyrorë ose shoqërorë). Shembuj tipikë janë proceset biologjike (p.sh. sëmundjet)

	<p>dhe proceset shoqërore (p.sh. lëvizjet kulturore). Këtu bëjnë pjesë proceset e ndryshme si: fizike, biologjike, kimike, psikologjike, mjedisore, ekonomike, kulturore, historike etj. Shembuj: Plakja, Ciklonet tropikale, Paqja, Budizmi, Religjioni dhe problemet shoqërore, Epidemitë, Lufta e Dytë Botërore (1939–1945).</p> <p>Përrjashtime: Nëse bëhet fjalë për veprime, të cilat nuk i shkakton një akter i vetëm dhe në të njëjtën kohë pikëpamja e procesit nuk dominon, ato klasifikohen në "b1".</p>
c1	<p><i>forma</i></p> <p>Entitetet që janë lëndore, abstrakte ose frut i krijimtarisë njerëzore dhe kanë formën e tyre të të shprehurit (me shkrim, përmes muzikës etj.). Këtu bëjnë pjesë termat për "zhanret" dhe "format", që dokumentet i prezantojnë në mënyrë konkrete si formë fizike ose në mënyrë abstrakte si formë e veprimtarisë intelektuale. Përfaqësohen fusha të ndryshme të komunikimit: gjuha (shkrimi, figurat retorike), arti dhe aktivitetet interpretuese (skenarët, portretet), letërsia (llojet dhe zhanret letrare, letërsia popullore), muzika (zhanret dhe veprat muzikore). Shembuj: Librat, Metonimia, Gjuha shqipe, Përkthimet në gjuhën franceze, Përrallat, Simfonia.</p> <p>Përrjashtime: Dokumentet, tek të cilat në plan të parë nuk është forma fizike, mirëpo mjetet për arritjen e një qëllimit (p.sh. statutet), klasifikohen në "c6".</p>
c2	<p><i>objekte</i></p> <p>Gjërat që mund të preken dhe janë të palëvizshme. Hapësirën mund ta zënë përgjithmonë ose përkohësisht (p.sh. zona e ndërtimit). Këtu bëjnë pjesë konstruksionet e ndryshme (p.sh. ndërtesat) dhe infrastruktura. Shembuj: Amfiteatret, Laboratorët, Ballkonët, Altarët, Konstruksionet bartëse, Fortifikatat, Kanalet.</p>
c3	<p><i>lëndë</i></p> <p>Gjërat që mund të preken dhe janë të lëvizshme. Këtu bëjnë pjesë edhe gjërat e përmasave shumë të mëdha, nëse janë potencialisht të lëvizshme. Dominon aspekti fizik. Shembuj: Talismanët, Kitara, Mbetjet arkeologjike, MAN (kamionë), Avionët.</p> <p>Përrjashtime: Lëndët që nuk janë të lëvizshme klasifikohen në "c2" (nëse vetitë e të dyjave mbulohen, përparësi u jepet objekteve); bartësit fizikë të informacioneve, tek të cilët përmbajtja e të dhënave ose mesazhi janë në plan të parë, klasifikohen në "c1".</p>
c4	<p><i>hapësirë</i></p> <p>Termt nga hapësira, krahina, zona dhe termt e tjerë që janë të lidhur me hapësirën, e jo me entitetin që e zë atë hapësirë. Këtu bëjnë pjesë edhe termt e lidhur me kozmosin. Shembuj: Kopshtet, Fshati, Llixhat, Shtetet e Bashkimit Evropian, Toka, Atmosfera, Yjet.</p> <p>Përrjashtime: Nëse gjërat zënë përgjithmonë hapësirën fizike, e cila ka ndryshuar rrënjësisht për shkak të ndërhyrjes njerëzore dhe jo për shkak të ndryshimit të krahinës, ato klasifikohen në "c2". Zonat e ndërtimit (p.sh. zonat banesore, zonat urbane) klasifikohen në "c2", kur aspekti i ndërtimit hedh mbi natyrën hapësinore të termit, domethënë nëse janë të përfaqësuara nga aspekti arkitekturor dhe inxhinierik dhe jo ai shoqëror, urbanistik ose ekologjik.</p>
c5	<p><i>substancia</i></p> <p>Termt që kanë të bëjnë me substancën (përbërja, vetitë, gjendja fizike) dhe vet substancat: elementet kimike, substancat kimike dhe fizike si dhe produktet ose materialet, që kanë pësuar transformim të caktuar, mirëpo ende nuk janë lëndë (ekstraktet, produktet e përpunuara, gjysëmproduktet). Këtu bëjnë pjesë edhe produktet, të cilat pavarësisht transformimit nuk humbin natyrën e tyre (ushqimet, medikamentet etj.). Shembuj: Mikrostruktura, Vetitë fizike, Natriumi, Mineralet, Uji, Tymi, Atomi, Vitamina C, Mjaltat, Vera, Mishi i deles, Qershia (frutat), Antibiotikët.</p> <p>Përrjashtime: Produktet e gatshme klasifikohen në "c3"; produktet jomateriale të veprimtarisë njerëzore klasifikohen në "c6" ose në "c1".</p>
c6	<p><i>mjete josubstanciale</i></p> <p>Gjërat, elementet, situatat dhe termt abstraktë, që janë mjete me anë të të cilave dëshironi të arrini diçka. Përmbajtjet lëndore janë dytësore (p.sh. bilancet, aktet ligjore janë kryesisht financiare dhe mjete ligjore, e më vonë edhe dokumente). Këtu bëjnë pjesë mjetet për përdorim</p>

	të përgjithshëm, mjetet për vlerësim dhe mjetet e tjera të lidhura me disiplinat dhe veprimtaritë, siç janë mjetet ekonomike dhe ligjore, termat filozofikë, mjetet e shkencës dhe teknologjisë me konceptet e tyre, metodat dhe teoritë. Shembuj: Paratë, Pagat, Tregu financiar, Ligji, Të drejtat e grave, Skolastika, Ligji i Avogadros, Darwinizmi, Teoria e shumicës. Përfshijmë: Dokumentet, tek të cilat në plan të parë është forma fizike dhe nuk janë vetëm mjete për arritjen e ndonjë qëllimi, klasifikohen në "c1".
d1	<i>periudha</i> Intervali kohor dhe periudha në historinë njerëzore dhe tokësore. Shembuj: Ditët, Gusht, Vera, Puberteti, Moshë, Neoliti, Mesjeta, Shekulli 1, 1980 (viti).
d2	<i>koncepte të tjera kohore</i> Termet e përgjithshëm, tek të cilët në plan të parë është aspekti kohor. Shembuj: Saktësia (koha), Vonesa, Orari i punës, Përvjetorët, Festat.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban formën e emrit të përgjithshëm si pikëqasje lëndore, që është përcaktuar në përputhje me sistemin e emërtimeve lëndore.

Në SGC përcaktuesi përdoret vetëm në regjistrimet referuese.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

- 450** *VARIANT I PIKËQASJES – EMËR I PËRGJITHSHËM*
550 *PIKËQASJA NË LIDHSHMËRI – EMËR I PËRGJITHSHËM*
750 *PIKËQASJA E NJËSUAR NË GJUHË DHE/APO SHKRIM TJETËR – EMËR I PËRGJITHSHËM*

SHEMBUJ

1.

250	uu	aEducation yItaly
-----	----	-------------------

2.

250	uu	aConstruction industry xLaw and legislation
-----	----	---

3.

250	uu	aBiology xPeriodicals
-----	----	-----------------------

4. * COBISS.net

152	uu	bsgc
250	uu	aAntropologjia

5. * COBISS.net

152	uu	bsgc
250	uu	a Sinteza organike (kimia)

6. *

152	uu	bsgc
250	uu	nc mc3 a Trobila

7. * COBISS.net

152	uu	bsgc
250	uu	nb mb1 a Trafiku hekurudhor

8. * COBISS.net

152	uu	bsgc
250	uu	na ma2 a Supermarketet

9. * COBISS.net

152	uu	bsgc
250	uu	nc mc6 a Linux (sistem operativ)

10. * COBISS.net

152	uu	bsgc
250	uu	nc mc2 a Ndërtesa betoni

11. * COBISS.net

152	uu	bsgc
250	uu	nc mc4 a Metropolet